



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të nenit 66 dhe 67 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregullores nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rregullores nr. 03/2017 për procedurat e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese, në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shpall:

K O N K U R S
Për plotësimin e vendeve të lira të punës

1. **KOZ-01/2018 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Gllgoc,**
2. **KOZ-02/2018 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Deçan,**
3. **KOZ-03/2018 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Shtërpce,**
4. **KOZ-04/2018 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Gjakovë dhe**
5. **KOZ-05/2018 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Skenderaj.**

Grada/Koeficienti: Niveli Profesional- G6 -13.5 / aktual 8

Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë: Drejtori i Departamentit të Koordinimit në Teren

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat, pas periudhës provuese 1(një) vjeqare

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:

1. Kryeson Komisionin Komunal Zgjedhor në bashkëpunim të plotë me Sekretariatit e KQZ –së;
2. Mbikëqyrë dhe u cakton detyra anëtarëve të tjerë të KKZ –së;
3. Mbikëqyrë punën e trupave zgjedhore në komunën përkatëse;
4. Bën raporte për aktivitetet në periudhën zgjedhore dhe jo zgjedhore;
5. Koordinon aktivitetet në mes KKZ-së dhe Administratës Komunale dhe SKQZ-së;
6. Informon SKQZ-në, lidhur me kërkesat e Kuvendit Komunal për zëvendësimet e këshilltarëve komunal;
7. Ndihmon dhe këshillon subjektet politike dhe organizatat joqeveritare për zgjedhje;
8. Kryen detyra të tjera kur i caktohen nga mbikëqyrësit e drejtëpërdrejtë.

Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:

1. Të ketë Diplomë Universitare në Drejtësi, Shkenca Politike dhe Administratë Publike;
2. Së paku katër (4) vite përvojë pune;
3. Integritet të lartë personal dhe profesional;
4. Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhët zyrtare;
5. Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike;
6. Njohje e gjuhës tjetër zyrtare e dëshirueshme
7. Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme;
8. Njohje të teknologjisë informative (MS Word, MS Excel dhe MS Access);

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Personelit, dhoma nr. 21, kati I-rë, Ish Ndërtesa e Bankës së Lubjanës,, Rruga "Migjeni" 10000 Prishtinë. Aplikacionet mundë të dorëzohen edhe në formë elektronike të skenuara në adresën elektronike: zyra.personeli@kqz-ks.org.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në numrin e tel: 038-200-23-557, prej orës 08:00 – 16:00, ose vizitoni ueb faqen e KQZ-së, në linkun: www.kqz-ks.org. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurren, certifikatën që nuk jeni nën hetime si dhe dy formularët e fundit të vlerësimit nga institucioni ku keni punuar. Kandidatët duhet të jenë persona me të drejtë vote në komunat e tyre përkatëse.

Kandidatët të cilën hyjnë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose nëpërmjet telefonit nga zyra e personelit. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Afati i konkursit është 15 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor, prej datës: 29.09.2018 deri me datë: 13.10.2018 në ora 16:00. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe inkurajon aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, si dhe pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë personat me aftësi të kufizuar.